

Ne të ndihmojmë të gjesh një punë të re

Nëse të kanë pushuar nga puna, për shkak se nuk ka punë, për shkak të sëmundjes ose nëse e ke përfunduar një punësim të përkohshëm, ti mund të marrësh ndihmë, nga Fondi i sigurisë TSL, që të gjesh një punë tjetër, të startosh një ndërmarrje vetjake, ose të fillosh të studiosh. Mbështetja përfshihet nga marrëveshja kolektive, e cila vlen në vendin tënd të punës dhe kjo është falas për ty.

### **Kjo përfshihet në mbështetje**

Ne të ofrojmë udhëzues personal për të kërkuar punë, bazuar në gjendjen tënde, ai të mbështet, gjatë këtij rrugëtimit. Udhëzuesi për të kërkuar punë, të ndihmon, për shembull, me kontaktet, me kërkesat dhe me CV dhe me përgatitjen tënde për intervista. Ti, po ashtu, mund të marrësh mbështetje, me kontaktet tua me organet zyrtare, si me Arkën e sigurimit dhe me Ndërmjetësinë e punës.

Nëse ti ke nevoja të veçanta, për shkak të sëmundjes, ti mund të marrësh mbështetje të përforcuar, të përshtatur sipas shëndetit tënd, me synimin që ti të gjesh një punë të re, sipas aftësisë tënde për punë.

Ti mund të kesh mundësinë të marrësh një ndihmesë për shkollim, nëse ai shkollim i rritë mundësitë e tua për punë, në tregun e punës dhe shpejt kjo mund të shpie në gjetjen e një pune të re. Ti, po ashtu, mund të marrësh ndihmë me vlerësimin e dëftësive, çka do të thotë nxjerrje në pah dhe të konfirmosh diçka, që ti tashmë e ke.

Nëse ti i ke mbushur 40 vjet, ti, po ashtu, mund të kesh të drejtë, të marrësh kompensim ekonomik, që quhet, ndihmë me të holla për të papunët (AGB).

Nëse konstaton se ti dëshiron të fillosh të studiosh për një kohë më të gjatë, për shembull, të arrish një profesion të ri, mund të marrësh udhëzime për karrierën dhe për studime, nga Fondi i sigurisë, TSL. Ka edhe mundësi të ndryshme për mbështetje ekonomike, që bën që ti mund të kesh pjesën më të madhe të të ardhurave të mëhershme, gjatë kohës së shkollimit tënd.

### **Kështu bëhet:**

Nëse ti pushohesh nga puna, pse nuk ka punë, atëherë ndërmarrja jote dhe përfaqësuesi yt i sindikatës kërkon mbështetjen. Nëse ti pushohesh nga puna, për shkak të sëmundjes ose pas përfundimit të një punësimi të përkohshëm, atëherë mundesh edhe vet të kërkohesh ndihmën. Kërkesa bëhet në uebfaqen tonë të TSL-se.

1. Fondi i sigurisë TSL, të kontakton ty, për të folur për gjendjen tënde dhe për mbështetjen në vazhdim, që ti mund të marrësh.
2. Nëse ti i thua po mbështetjes në vazhdim, atëherë të caktohet një udhëzues personal për kërkim të punës, i cili të ndihmon ty.
3. Udhëzuesi për kërkim të punës, të mbështet për gjatë rrugëtimit, të gjetjes së një pune të re, të studimit ose të startit të një ndërmarrje vetjake.
4. Nëse ka nevojë, ti, po ashtu, ke mundësi të sigurohet një vend për t'u shkolluar.
5. Nëse ti je mbi 40 vjeç, ti mund të marrësh ndihmë për të kërkuar, ndihmën në të holla për të papunët (AGB), tek Afa Siguracioni.

### **Kushtet themelore për të marrë ndihmën:**

- Ti ishe herën e fundit i punësuar në një ndërmarrje me marrëveshje kolektive, në kuadër të Industrisë dhe Tregtisë Suedeze dhe të LO:s.
- Ti ke punuar, së paku 12 muaj nga 24 muajt e fundit.
- Ti je më i ri se 65 vjeç.

Për disa pjesë të mbështetjes, vlejné edhe kushte të tjera.

### **Më shumë informacion për ndihmë personale**

Më shumë informacion për mbështetjen, ka në uebfaqen tonë TSL.se. Në krye të uebfaqes, është një mjet, kur mund të ndërrosh gjuhën.

Je i mirëseardhur të na kontaktosh, për ndihmë personale.

- Përmes telefonit 010-480 91 20
- Përmes e-postës: [info@tsl.se](mailto:info@tsl.se)